


Për :	Zyrën e Rregullatorit të Energjisë
Nga:	Valdete Marevci-Dërmaku - Koordinator e Ndërmarrjes me Institucione tjera
Përmes:	Kastriot Bllaca – Ushtrues Detyre Kryeshef Ekzekutiv i NP "Termokos" SH.A-Prishtinë
Data:	29.09.2025
Subjekti :	Raportimi Rregullativ i N.P "Termokos" Sh.A. Prishtinë në kuadër të Aplikimit për shqyrtim të tarifave për sezonin e ngrohjes 2025/2026

Në lidhje me shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2025/2026, ju përcjellim të bashkangjitura këto raporte:

- Pasqyrat Rregullative me të dhënat e parashikuara për periudhën (15 tetor 2025 – 15 tetor 2026),
- Shpalosja e Pasqyrës B,
- Raportet e detajuara, në kuadër të aplikimit për shqyrtimin tarifar për sezonin ngrohës 2025/2026, të cilat përmbajnë:
 - Planifikimi i prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B dhe në ngrohtoren qendrore të NP "Termokos" SH.A,
 - Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë ,
 - Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve,
 - Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik
 - Planifikimi i kycjeve të reja,
 - Planifikimi i investimeve me vetfinancim dhe nga donacionet.
- Përgjigjet e NP "Termokos" sh.a në komentet e dhëna nga ZRRE, në Aplikacionin për shqyrtimin e tarifave për sezonin 2025/2026,
- Dokumentet plotësuese lidhur me sqarimet e kërkuara nga ZRRE:
 - Kontrata për punët e papalanifikuara per ndertimin e objektit administrativ ,
 - Kontrata për punët e paparashikuara per ndertimin e objektit administrativ,
 - Tabela e shpenzimeve te planifikuara per projektin "Solar 4 Kosova II".
 - Dokumenti nga "Enerco" -Adendum.02 DOC. NO:250326-01, për projektin "Prishtina Heat Save"- (dërguar me e-mail në ZRRE me datë 11.08.2025).



Nr. 944/20
Data. 30.09.25

TERMOKOS SH.A.
J.S.C.
D.D.

PRISHTINE-PRISHTINA-PRISTINA

Nr. 2289/1 Dt. 29. 09 2025




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



PASQYRAT (DEKLARATAT) RREGULLATIVE

Planifikimet
/Sezoni 2025-2026/



Nr. 945 125
Data. 30.09-25



Raportimi Rregullativ - Shqyrtimi i tarifave - Sezoni 2025-2026

Ndërmarrja:

NP "Termokos" Sh.a

Periudha:

15.10.2025 - 15.10.2026

Pasqyra A - G1, G2 : Pasqyra e Aseteve Operative

Në Euro

	Asetet Drejtëpërdrejt të Përcaktuara		Asetet Mbështetëse	Asetet e përbashkëta	Totali i Aseteve
	Prodhimi i ngrohjes	Distribuidimi dhe furnizimi i ngrohjes			
a	c	d	e	f	g
1	Çmimi i blerjes me koston historike	28,656,624.00	43,483,405.15	3,621,824.62	78,023,328.62
2	Zhvlerësimi i akumuluar	15,366,494.00	13,587,338.86	362,768.14	29,636,892.25
3	Vlera sipas librave kontabël	13,290,130.00	29,896,066.29	3,259,056.48	48,386,436.37
4	Çmimi zvendësues në vlerën e tregut				0.00

Aprovuar nga:	Punuar nga:
Emëri e Mbiemëri / Pozita	Emëri e Mbiemëri / Pozita
Artion Shabani- ZKFTH	Udhëheqse e Kontabilitetit
Nënshkrimi:	Luljeta Muqolli
Kastriot Bllaca - U.D. Kryeshef Ekzekutiv	Nënshkrimi:
Nënshkrimi:	
Date: 29.09.2025	Date: 29.09.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORMI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raportimi Rregullativ - Shqyrtimi i tarifave - Sezoni 2025-2026

Ndërmarrja: **NP "Termokos" Sh.a**

Periodha: **15.10.2025-15.10.2026**

Pasqyra B - G1, G2 : Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Në Euro

		Drejtëpërdrejt të Përcaktuara		Mbështetëse	Të Përbashkëta	Total
		Prodhimi I Ngrohjes	Distribuimi dhe Furnizimi i ngrohjes			
	a	c	d	e	f	g
1	Të Ardhurat e lejuara					
2	Të ardhurat nga shitja e ngrohjes		10,904,406.52			10,904,406.52
3	Të ardhurat tjera të lejuara/ Grantet			3,547,816.53		3,547,816.53
4	Totali i të ardhurave të lejuara				0.00	14,452,223.05
5	Shpenzimet e lejuara					
6	Shpenzimet Operacionale					
	Shpenzimet variabile :					
7	Energjia termike nga kogjenerimi	1,958,719.61				1,958,719.61
8	Karburanti					0.00
9	Uji I trajtuar	72,249.00				72,249.00
10	Kemikalet për trajtimin e ujit	43,332.50				43,332.50
11	Elektriciteti	931,929.64	1,080,495.84			2,012,425.48
12	Shpenzimet e Personelit (puna direkte në prodhim)	459,254.14	1,377,762.41			1,837,016.55
13	Shpenzimet tjera variabile					
14	Totali i shpenzimeve variabile				0.00	5,923,743.14
15	Shpenzimet fikse					
16	Riparimet dhe mirëmbajtja				285,410.00	285,410.00
17	Materialet dhe shërbimet				98,000.00	98,000.00
18	Shpenzimet për administratë				258,300.00	258,300.00
19	Shpenzimet e personelit				2,342,476.53	2,342,476.53
20	Shpenzimet e Shitjes dhe tjera Administrative				508,971.00	508,971.00
21	Totali i shpenzimeve fikse				3,493,157.53	3,493,157.53
22	Totali i shpenzimeve operative				9,416,900.67	9,416,900.67
22	Zhvlerësimi				3,222,426.05	3,222,426.05
22	Totali i Shpenzimeve të Lejuara				12,639,326.72	12,639,326.72

Aprovuar nga:	Punuar nga:
Emëri e Mbiemëri / Pozita	Emëri e Mbiemëri / Pozita
ZKFTH	Udhëheqëse e Kontabilitetit
Arton Shabani	Euljeta Muqolli
Nënshkrimi :	Nënshkrimi:
Kastriot Billaca - U.D. Kryeshef Ekzekutiv	
Nënshkrimi :	
Data: 29.09.2025	Data: 29.09.2025





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Raportimi Rregullativ - Sezoni 2025/2026

Ndërmarrja

NP"Termokos"Sh.A.

Periudha: 15 tetor 2025-15 tetor 2026

Pasqyra C-G2 : Pasqyra e Faturimit dhe Arkëtimit të Pagesave

Faturimi me matje - sipas konsumit të matur										
	Sip. Ngrohëse [m2]	Kapac. Termik [kW]	Kons. i En. Term. [MWh]	Faturimi për kapac. [EUR]	Faturimi për energji [EURO]	Total faturimi [EURO]	Arkëtimi [EURO]	Arkëtimi [%]	Borxhi [EURO]	Borxhi [%]
1	547,177.40	557,962.09	66,040.59	459,178.17	2,501,645.74	2,960,823.91	2,806,361.57	94.78	154,462.34	5.22

	Sip. Ngrohëse [m2]	Kapac. Termik [kW]	Kons. i En. Term. [MWh]	Faturimi për kapac. [EUR]	Faturimi për energji [EURO]	Total faturimi [EURO]	Arkëtimi [EURO]	Arkëtimi [%]	Borxhi [EURO]	Borxhi [%]
C11+C22	1,052,845.25	862,401.93	102,058.31	655,425.46	3,577,143.62	4,232,569.08	3,386,055.26	80.00	846,513.82	20.00

Faturimi pa matje - sipas sipërfaqjes ngrohëse							
	Grupi i konsumatorëve	Sipërfaqja Ngrohëse [m2]	Faturuar [Euro]	Arkëtuar [Euro]	Shkalla e Arkët. [%]	Borgji [Euro]	Borgji [%]
2	Shtëpiak (Amvisri)	613,675.94	2,798,362.29	1,555,172.85	80.00	1,243,189.44	20.00
3	Komercial dhe Institucional	142,745.83	813,651.23	346,021.29	80.00	467,629.94	20.00
4	Total	2,356,444.42	3,612,013.52	1,901,194.14	76.97	1,710,819.38	23.03

5	Total (me matje + pa matje) [EURO]	10,805,406.51	8,093,610.97	83.30	2,711,795.54	16.70
---	------------------------------------	---------------	--------------	-------	--------------	-------

Sqarim: Vlerat janë pa TVSH.

Aprovuar nga:	Punuar nga:
Emëri e Mbiemëri / Pozita	Emëri e Mbiemëri / Pozita
Kastriot Blaca - U.D.Kryeshf. Ekzekutiv	Raiç Vllja - Drejtori i Furnizimit
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:
Data: 29.09.2025	Data: 29.09.2025





Raportimi Rregullativ - Shqyrtimi i tarifave - Sezoni 2025-2026

Ndërmarrja		NP"Termokos"Sh.A.		Periudha:		15.10.2025-15.10.2026	



Raportimi Rregullativ - Shqyrtim i tarifave - Sezoni 2025 / 2026

Ndërmarrja:

Periudha:

NP"Termokos"Sh.A.

15.10.2025-15.04.2026

Pasqyra E - G1, G2 - Pasqyra Teknike

Të dhënat e përgjithshme teknike

1	Kapaciteti i instaluar i energjisë termike(ngrohjes) në ngrohtore	MW	134.00
2*	Kapaciteti i instaluar i energjisë termike nga kogjenerimi	MW	140.00
3	Kapaciteti i disponueshëm i energjisë termike(ngrohjes) në ngrohtore	MW	134.00
4*	Kapaciteti i disponueshëm i energjisë termike(ngrohjes) nga kogjenerimi	MW	140.00
5*	Gjatësia e rrjetit të transportit të en.term.KEK-Termokos	km	12.00
6	Gjatësia e rrjetit të distribuimit	km	111.00
7	Numri i nënstacioneve	-	896.00
8	Numri i nënstacioneve aktive	-	876.00

Bilanci i energjisë

6	Energjia e futur nga karburanti	MWh	0.00
7	Prodhiimi bruto i ngrohjes në ngrohtore	MWh	0.00
8*	Sasia e energjisë termike nga kogjenerimi	MWh	414,446.00
9*	Humbjet ne rrjetin e transportit	MWh	8,289.00
10	Konsumi vetanak	MWh	500.00
11	Prodhiimi neto i energjisë termike(ngrohjes)	MWh	405,657.00
12	Efikasiteti total i energjisë termike	%	0.98
13	Konsumi i ujit	m3	85,000.00
14	Konsumi i elektricitetit	MWh	10,179.00

Bilanci i ngrohjes

13	Sasia e ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit (e matur)	MWh	405,657.00
14	Furnizimi i konsumatorëve me ngrohje (e matur)	MWh	378,276.00
15	Humbjet e distribuimit	MWh	27,382.00
16	Humbjet e distribuimit ne përqindje	%	6.75

Të dhënat për konsumatorë

Të dhënat për konsumatorë			Konsumatorët Shtëpijak	Konsumatorët Komercial dhe Institucional	Total / mesatare
17	Kapaciteti i kontraktuar i ngrohjes	MW	156,123.67	95,424.93	251,548.60
18	Totali i sipërfaqes së ngrohur	m2	1,561,236.69	795,207.75	2,356,444.44
19	Kërkesa specifike për kapacitetin e ngrohjes	W/m2	100.00	120.00	110
20	Orët e ngarkesës së plotë	h	1,500.00	1,500.00	1500
21	Kërkesa për ngrohje (furnizimi me ngrohje l kalkuluar)	MWh	234,185.50	143,137.40	377,322.90

Konsumi i karburantit

	Sasia tona	Vlera (LHV) MWh/t	Energjia në karburant MWh
22	Nafta e rëndë (mazuti)	11.30	0.00
23	Nafta e lehtë (diesel D2)		0.00

* Pozicionet e shënuara me hyllëz vlejné për rastet kur ekzistojné stabilimentet e kogjenerimit (p.sh. Aktualisht NQ Termokos)

Aprovuar nga :	Punuar nga:
EMRI e MBIEMRI / Pozita	EMRI e MBIEMRI / Pozita
Drejtor i Distribuimit	Ndihmës Drejtor i Distribuimit
Valdrin Krasniqi	Adem Govori
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:
U.D.Kryeshef Ekzekutiv	Florent Hoxha -Drejtor i Prodhimit
Kastriot Billaca	Nënshkrimi:
Nënshkrimi:	Date: 29.09.2025
Date: 29.09.2025	



Raportimi Rregullativ - Planifikimi- Sezoni 2025/2026

Ndërmarrja

NP" Termokos "sh.a

tetor 2025-tetor 2026

Pasqyra B - G1, G2 : Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

		VITI 2025	VITI 2026	Total
1	Të Ardhurat e lejuara	(15 tetor - dhjetor) 2025	(janar - 15 tetor) 2026	15 Tetor 2025 - 15 Tetor 2026
2	Të ardhurat nga shitja e ngrohjes	4,581,492.36	6,872,238.55	11,453,730.91
41100	Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Sektori Banesor	2,801,653.97	4,202,480.96	7,004,134.93
41110	Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Sektori Afarist	524,449.05	786,673.58	1,311,122.63
41120	Të ardhurat nga shërbimet e ngrohjes - Institucional	1,255,389.34	1,883,084.01	3,138,473.35
3	Të ardhurat tjera të lejuara	-222,329.76	-326,994.63	-549,324.39
41140	Të ardhurat nga kyqjet (ç'kyqjet) e ngrohjes	1,200.00	2,000.00	3,200.00
45000	Të ardhurat nga shërbimet tjera	15,000.00	25,000.00	40,000.00
45100	Të hyrat nga taksat gjyqësore-taksat për administrimin e lëndëve përmbartimore	5,800.00	15,000.00	20,800.00
41130	Të ardhurat nga rrjeti sekondar	15,000.00	20,000.00	35,000.00
43100	Zbritjet e lejuara nga faturimi	-259,329.76	-388,994.63	-648,324.39
4	Totali i të ardhurave të lejuara	4,359,162.60	6,545,243.92	10,904,406.52
5	Shpenzimet e lejuara			
6	Shpenzimet Operacionale			
7	Nga kjo: Shpenzimet variabile			
8	këtu hyjnë: Karburanti	793,371.23	1,165,348.38	1,958,719.61
50300	Energjia termike nga ko-gjenerimi	776,604.00	1,140,691.00	1,917,295.00
50001	Nafta per prodhim	0.00	0.00	0.00
50000	Mazuti per prodhim	0.00	0.00	0.00
60500	Shpenzimet per raport te analizave te mazutit	0.00	0.00	0.00
79200	Shpenzimet për licencë për shpërndarje të ngrohjes	16,767.23	24,657.38	41,424.61
9	Uji	32,512.00	39,737.00	72,249.00
50100	Shpenzimet e ujit	32,512.00	39,737.00	72,249.00
10	Kemikalet per trajtimin e ujit	18,191.25	25,141.25	43,332.50
	Kemikalet	18,191.25	25,141.25	43,332.50
260000	Elektriciteti	931,929.64	1,080,495.84	2,012,425.48
50200	Shpenzimet e energjisë elektrike (Prodhim)	723,668.32	811,513.60	1,535,181.92
50201	Shpenzimet e energjisë elektrike (Nënstacione)	208,261.32	268,982.24	477,243.56

12	Shpenzimet e Personelit (puna direkte ne prodhim)	459,254.14	1,377,762.41	1,837,016.55
71200	Prodhimi	116,521.80	349,565.40	466,087.20
71200	Distribuimi	320,863.09	962,589.28	1,283,452.37
71201	Kontributet për kontribute pensionale (Pundhënësi)	21,869.24	65,607.73	87,476.98
13	Shpenzimet tjera variabile	0.00	0.00	0.00
66000	Shpenzimet e interesit të kredisë			
79900	Shpeizimet e provizionimeve te L/A			
14	Totali i shpenzimeve variabile	2,235,258.26	3,688,484.88	5,923,743.14
15	Shpenzimet fikse			
16	këtu hyjnë: Riparimet dhe mirëmbajtja	78,120.00	207,290.00	285,410.00
70500	Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve	1,500.00	3,500.00	5,000.00
70300	Shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve	5,000.00	7,500.00	12,500.00
70200	Shpenzimet për mirëmbajtjen e kompjut.	0.00	3,500.00	3,500.00
70400	Shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve	10,000.00	50,000.00	60,000.00
70700	Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve	500.00	1,500.00	2,000.00
70800	Shpenzimet për mirëmbajtjen e programeve	0.00	12,000.00	12,000.00
61500	Shpenzimet e sigurimeve të objektit		10,000.00	10,000.00
60301	Shpenzimet e sigurimit të automjeteve	1,920.00	3,000.00	4,920.00
60300	Regjistrimi i automjeteve	2,400.00	3,600.00	6,000.00
60302	Shpenzimet e kontrolles teknik	300.00	700.00	1,000.00
60303	Shpenzimet për taksat rrugore	500.00	2,000.00	2,500.00
60800	Shpenzimet e taksave komunale	2,000.00	4,000.00	6,000.00
60000	Shpenzimet për punimin e pushtetave	5,000.00	10,000.00	15,000.00
76000	Shpenzimet për mbrojtje kundër zjarrit	1,000.00	5,000.00	6,000.00
60100	Shpenzimet për rregullimin e rrugëve të d	18,000.00	35,000.00	53,000.00
70100	Shpenzimet per servisimin e pompave		990.00	990.00
60101	Shpenzimet për bartjen e reres (heqja e r	10,000.00	20,000.00	30,000.00
60200	Shpenzimet përshpime dhe vendosje te d	20,000.00	35,000.00	55,000.00
17	Materialet dhe shërbimet	45,000.00	53,000.00	98,000.00
61200	Shpenzimet materiale të mirëmbajtjes	35,000.00	35,000.00	70,000.00
61250	Shpenzimet e materialit elektrik	5,000.00	10,000.00	15,000.00
61300	Shpenzimet e materialit zyrtar	5,000.00	8,000.00	13,000.00
18	Shpenzimet për administratë	75,550.00	182,750.00	258,300.00
74100	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar	20,000.00	30,000.00	50,000.00
74200	Shpenzimet per ekskurzion	4,500.00	10,500.00	15,000.00
75200	Shpenzimet e byfësë	2,000.00	4,800.00	6,800.00
61330	Shpenzimet për hixhienë	800.00	1,200.00	2,000.00
75300	Shpenzimet per larje te automjeteve	300.00	1,200.00	1,500.00
78000	Shpenzimet e derivateve	6,000.00	10,000.00	16,000.00
74000	Shpenzimet e reprezentacionit	4,000.00	8,000.00	12,000.00

79100	Shpenzimet për avokat	500.00	1,500.00	2,000.00
79150	Shpenzimet e permbarimit	20,000.00	45,000.00	65,000.00
79151	Shpenzimet e permbarimit-tarifa e efikasit	4,000.00	6,000.00	10,000.00
71002	Shpenzimet për mbushje telefonike	3,000.00	5,000.00	8,000.00
71001	Shpenzimet e telefonisë mobile	1,500.00	3,500.00	5,000.00
71000	Shpenzimet e telefonisë fikse	150.00	300.00	450.00
72000	Shpenzimet e internetit	1,800.00	4,200.00	6,000.00
72445	Shpenzimet e perkthimit	0.00	600.00	600.00
72400	Shpenzimet e qiras	5,000.00	15,000.00	20,000.00
72401	shpenzimet e marrjes se auomjeteve me	0.00	0.00	0.00
70600	shpenzimet per mirmbajtejen e oborrit	2,000.00	15,000.00	17,000.00
65002	shpenzimet per certifikata shendetstore		20,000.00	20,000.00
72500	Shpenzimet për mirëmbajtjen e web faqe	0.00	950.00	950.00
19	Shpenzimet e personelit	585,619.13	1,756,857.39	2,342,476.53
71200	Departamenti Administrativ	138,391.14	415,173.42	553,564.56
71200	Departamenti Financiar	53,585.45	160,756.35	214,341.80
71200	Pagat për Bordin e Drejtorve dhe Aksionaret	16,668.84	50,006.52	66,675.36
71200	Zyrtaret e Lartë	29,389.92	88,169.76	117,559.68
71200	Departamenti i Prokurimit	108,922.56	326,767.68	435,690.24
71200	Zyra Mbështetëse	12,484.05	37,452.15	49,936.20
71200	Departamenti i Furnizimit	98,064.75	294,194.25	392,259.00
71200	Departamenti për Zhvillim dhe Instimet Ka	49,790.91	149,372.73	199,163.65
71200	Zyra Ligjore	33,126.72	99,380.16	132,506.88
71200	Zyra e Auditimit te Brendshem	4,049.04	12,147.12	16,196.16
65001	Shpenzimet për sigurimet shëndetësore	13,259.13	39,777.38	53,036.50
71201	Kontributet për kontribute pensionale (Pu	27,886.63	83,659.88	111,546.50
20	Shpenzimet e Shitjes dhe tjera Administrative	168,388.00	340,583.00	508,971.00
61600	Shpenzimet e provizioneve bankare	13,500.00	40,500.00	54,000.00
61701	Shpenzimet e mbeturinave	500.00	1,500.00	2,000.00
63100	Shpenzimet për festa	6,000.00	14,000.00	20,000.00
64000	Shpenzimet per ndihma	1,500.00	3,500.00	5,000.00
71300	Shpenzimet për tatimin në pronë	2,800.00	1,200.00	4,000.00
73000-73100	Shpenzimet për taksa gjyqësore	500.00	1,500.00	2,000.00
73500	Shpenzimet për shpallje dhe njoftim	600.00	1,000.00	1,600.00
63000	Shpenzimet tjera	4,000.00	6,000.00	10,000.00
61350	Shpenzimet për rroba mbrojtëse	0.00	14,758.00	14,758.00
61100	Shpenzimet e ngritjes profesionale - trajnime	30,000.00	50,000.00	80,000.00
75100	Shpenzimet e promovimit te afarizmit	15,000.00	65,000.00	80,000.00
71204	Shpenzimet per fizibilitet te mbulushmeris per Prishtinen	80,113.00	100,000.00	180,113.00
72300	Shpenzim për rivlesrim te asetëve	13,875.00	41,625.00	55,500.00
89000	Shpenzimet e tatimit ne fitim			0.00
21	Totali I shpenzimeve fikse	952,677.13	2,540,480.39	3,493,157.53
22	Totali I shpenzimeve operative	3,187,935.39	6,228,965.28	9,416,900.66
24	Zhvlerësimi	805,606.51	2,416,819.54	3,222,426.05
25	Totali I Shpenzimeve të Lejuara	3,993,541.90	8,645,784.81	12,639,326.71

Draft -Raportet e detajizuara në kuadër të Aplikimit për shqyrtim tarifor për sezonin ngrohës 2025/2026

Të nderuar,

N.P. "Termokos" SH.a, ka përgaditur dokumentacionin, raportet me të dhëna dhe informatat e kërkuara nga ZRRE në kërkesën e datës 05.06.2025, në lidhje me fillimin e shqyrtimit të tarifave të energjisë termike për sezonin 2025/2026.

Përveç Pasqyrave Rregullative të plotësuara me të dhëna të planifikuara, Shpalosjes së Pasqyrës B (të cilat ua dërgojmë si dokumente të bashkangjitura) , në këtë dokument janë dhënë edhe detajizime e shpjegime përkatëse që përmbajnë të dhënat e parashikuara për periudhën 15 tetor 2025 – 15 tetor 2026, që përfshinë sezonin e ardhshëm të ngrohjes 2025/2026.

Bazuar në kërkesën në fjalë, në këtë dokument janë paraqitur :

1.Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B dhe në ngrohtoren qendrore të NP "Termokos"SH.A

1.1 Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B

- Në tabelën 1. është paraqitur energjia termike e planifikuar dhe kostoja e energjisë termike për sezonin 2025/2026. Vlerësimi është bërë bazuar në kapacitetin e deklaruar dhe energjinë termike e cila derivon nga ky kapacitet (Kapaciteti x 6.56), ndërsa nuk është përfshirë TVSH. Në kosto është llogaritur edhe Taksa e Licencës për Energjinë Termike. Kalkulimi i kostonë së energjisë termike është bërë duke u bazuar në çmimin për kapacitet, energji termike dhe Taksën së Licencës për energjinë termike, të aplikuara gjatë sezonit 2024/2025.

**** Plani për vitin 2026 ende nuk është aprovuar nga KOST dhe ME!**

PLANIFIKIMI PËR SEZONIN 2025 / 2026			
Muaji	Kapaciteti i deklaruar MW	Energjia MWh _{TER}	Vlera e faturës pa TVSH/€
Tetor 2025	3,733	24,491	113,300
Nentor 2025	9,797	64,265	297,300
Dhjetor 2025	12,060	79,116	366,004
Janar 2026	13,266	87,028	402,603
Shkurt 2026	10,739	70,447	325,897
Mars 2026	9,950	65,271	301,953
Prill 2026	3,633	23,829	110,238
Total :	63,178	414,446	1,917,295

Tabela 1. Energjia termike e planifikuar për sezonin ngrrohtës 2025/2026

1.2 Planifikimi i prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit në ngrrohtore

- Aktualisht sasia bruto e mazutit në rezervuarë është 855 ton, kurse sasia neto (të shfrytëzueshme) janë 695 ton.
- Për sezonin 2025/2026, sa i përket prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet prodhuese në Ngrrohtore (me mazut), NP"Termokos" sh.a nuk ka planifikuar prodhim të energjisë termike nga mazuti për disa arsye, e të cilat janë:

1. Duke marrë parasysh vjetërsinë e kaldajave ekzistuese, gjendjen e keqe teknike të tyre, vitet e mosfunksionimit të tyre (që nga funksionalizimi i sistemit të koogjenerimit), etj, Termokos ka angazhuar ekspertë të specializuar në fushën përkatëse nga Fakulteti Teknik (FIM dhe FIN) të UP, të cilët kanë bërë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të kaldajave, oxhakut dhe rezervuarëve të mazutit (R3 dhe R4).

Andaj, bazuar në rekomandimet dhe konkludimet e grupit të ekspertëve të angazhuar sipas "Raportit për vlerësimin profesional të dy kaldajave, rezervuarëve të mazutit dhe oxhakut" (me Nr. Prot. 081 të datës 26.06.2024), grupi i ekspertëve pas një vlerësimi të hollësishtëm, konstatojnë se kaldajat ekzistuese kanë pësuar dëmtime të rënda në strukturën e tyre mekanike, elektrike dhe ndërtimore. Dëmtimet janë të atilla që operimi i tyre i sigurtë dhe efikas është i pamundur dhe çdo përpjekje për riparimin e tyre është e padobishme.

Prandaj, bazuar në këtë konstatim, dhe gjithashtu duke marrë parasysh edhe kushtet dhe normat e sigurisë dhe të ndotjes së ambientit (me përdorimin e mazutit), rekomadimi i grupit të ekspertëve është që kaladajat ekzistuese të zëvendësohen më kaladaja të reja më gaz.

Ndërsa, rezervuarta e mazutit të cilët kanë pësuar dëmtime nga korrozioni, duhet të zëvendësohen me pajisje mobile për sistemin e kaldajave me gaz, duke përdorur cisterna sipas kërkesës, ndërsa oxhaku duhet të riparohet nëse përdoret për gazëra dalëse.

Andaj, NP"Termokos" sh.a bazuar në rekomandimet dhe konkludimet e ekspertëve të angazhuar, do të marrë vendim mbi alternativat në të ardhmen, për të plotësuar kapacitetet e kërkuara në rast nevojë.

2. Stacioni i mazutit është larguar për shkak të ndërtimit të objektit administrativ, kurse për rivendosjen e tij kërkohet një kohë më e gjatë dhe kosto të lartë financiare.

3.Licenca e Prodhimit të energjisë termike të NQ Termokos, ka skaduar në fillim të tetorit 2021, dokumentet e kërkuara nga ZRRE lidhur me vazhdimin e kësaj licence, i kemi pranuar nga MMPHI (kronologjia e përshkruar më poshtë).

Në vijim po ju shpalosim kronologjinë e dërgimit të raporteve në MMPHI në kaudër të aplikimit për Leje Mjedisore të Integruar:

- Nga MMPHI është lëshuar Vendimi për Pëlqim Mjedisor për NP"Termokos" SHA me datë 27 .06.2022,
- Me datë 09.08.2022 kemi Aplikuar për Leje Mjedisore të integruar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI), ku janë dërguar Aplikacioni i plotësuar dhe dokumentet mbështetëse. Pas kësaj, mbështetur në kërkesat e MMPHI,

- Dërgimi i dokumentacioneve plotësuese dhe riplotësimit e pikave të Aplikacionit, në të cilin, ndër të tjera është dërguar edhe "Raporti i matjeve të emisionit të gazrave djegëse dhe të pluhurit" nga Enti i hulumtimeve "INKOS" Sh.A, sipas matjeve të datës 02.02.2023 në ngrohtoren qendrore Termokos, është bërë me datë 08.12.2022 dhe 11.05.2023,
- Pagesa e taksës për Leje Mjedisore të integruar nga Termokos është bërë me datë 08.04. 2024 ,
- Me datë 27.05.2025 , Termokosi ka pranuar Vendimin e lëshuar nga MMPHI me NR.prot.22/4501/MMPHI për lëshimin e Lejes mjedisore të integruar dhe " Lejen mjedisore të integruar " për NP"Termokos'SH.A.
- Në ZRRE me datë 29.05.2025 kemi dërguar Vendimin dhe " Lejen mjedisore të integruar " për NP"Termokos'SH.A.

Aktualisht , jemi në pritje të vendimit të ZRRE lidhur me procedurat e mëtutjeshme sa i përket qështjes së vazhimit të licencës së prodhimit të energjisë termike.

2. Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë në sezonin 2025/2026

Në tabelën 2. është pasqyruar planifikimi i pranimit të energjisë termike nga KEK, furnizimit të konsumatorëve me energji termike / ngrohje, si dhe humbjet në rrjetin e transportit (TC Kosova B-NQ Termokos), vetkonsumi dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Në këtë tabelë nuk është përfshirë planifikimi i prodhimit të energjisë në ngrohtore, pasi që ajo planifikohet vetëm për rastet emergjente.

PLANIFIKIMI I SASISË SË ENERGJISË DHE HUMBJEVE PËR SEZONIN 2025/2026									
Sezona 2025/2026									
	Kapaciteti i deklaruar	Energjia termike	Energjia termike e pranuar nga KEK	Humbjet e energjisë në rrjetin e transportit	Konsumi vetanak	Energjia neto e futur në rrjetin e shpërndarjes	Energjia e liferuar te konsumatorët	Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes	Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes
	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	%
Tetor 2025	3,733	24,491	490	24,001	40	23,961	22,344	1,617	
Nëntor 2025	9,797	64,265	1,285	62,980	85	62,895	58,649	4,245	
Dhjetor 2025	12,060	79,116	1,582	77,534	90	77,444	72,216	5,227	

Janar 2026	13,266	87,028	1,741	85,287	95	85,192	79,442	5,750
Shkurt 2026	10,739	70,447	1,409	69,038	90	68,948	64,294	4,654
Mars 2026	9,950	65,271	1,305	63,965	60	63,905	59,592	4,314
Prill 2026	3,633	23,829	477	23,353	40	23,313	21,739	1,574
Total:	63,178	414,446	8,289	406,157	500	405,657	373,276	27,382
								6.75

Tabela2. Planifikimi i energjisë termike dhe humbjeve në rrjetin e transportit të energjisë dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë.

- Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë është planifikuar të jenë 2%, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 6.75 %.

Humbjet e energjisë (ujit) në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 6.75%, pjesa më e madhe e këtyre humbjeve i referohet mbushjeve me ujë të trajtuar të rrjetit sekondar në objektet e reja, aty ku janë duke u instaluar nënstationet e reja.

Me realizimin e projektit me vetfinancim për zgjerimin e rrjetit në lagjen "Lakrishtë" do të bëhet kyçja e 18 objekteve të reja në kuadër të zgjerimit / dendsifikimit të rrjetit, rrjeti sekondar i të cilave mbushet vetëm nga rrjeti primarë. Gjithashtu në këtë nivel të humbjeve të energjisë (ujit) do të ndikojnë edhe rrjedhjet në segmente të caktuara të rrjetit, për shkak të vjetërsisë së rrjetit të shpërndarjes.

Andaj, elementet që ndikojnë në këtë nivel të parashikimit të humbjeve të energjisë (ujit) janë:

- Zgjerimi i rrjetit primarë,
- Pjesa sekondare e objekteve të reja do të mbushet me ujë nga rrjeti primarë,
- Segmentet e vjetëruara të rrjetit të shpërndarjes,
- Testimet hidraulike,
- Si procedurë, aty ku është e mundur, rrjeti sekondarë në të gjitha nënstationet mbushet nga rrjeti primar, me ujë të zbutur,
- Zbrazja e objekteve gjatë realizimit të projektit "Pristina Heat Save" për instalimin e matësve individual të energjisë termike.

3. Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve

Në tabelën 3, kemi paraqitur të dhënat aktuale për; numrin aktual i konsumatorëve aktiv, sipërfaqen ngrohëse dhe kapacitetin termik në varësi të sektorit të konsumatorëve.

Sektori	Numri aktual i konsumatorëve		
	Numri i konsumatorëve	Sipërfaqja /m ²	Kapaciteti termik /MW
Sektori Banesor	22,921	1,421,236.96	142.12
Sektori Biznesor	2,065	151,478.41	21.21
Sektori Institucional	297	613,729.34	85.92
TOTAL	25,283	2,186,444.71	249.25

Tabela 3. Numri aktual i konsumatorëve, sipërfaqet respektive dhe kapaciteti termik

4. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2025/2026

Në vijim, në mënyrë tabelare kemi paraqitur të përmbledhura, të dhënat për sipërfaqen, konsumin vjetor të energjisë dhe konsumin specifik vjetor, sipas planifikimit për sezonin 2025/2026.

Planifikimi - Sezona 2025/2026			
	Sipërfaqja/m ²	Konsumi vjetor i energjisë/MWh	Konsumi specifik KWh/m ² /vit
Konsumatorët shtëpiak	1,561,236.69	245,987.64	158.2
Konsumatorët Komercial dhe Institucional	795,207.75	131,209.28	165
Total	2,356,444.44	378,196.92	240.7

Tabela 5. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2025/2026

S. Planifikimi i kycjeve të reja gjatë sezonit 2025/2026

Lidhur me planifikimin e kycjeve të reja , në Tabelën 6, janë paraqitur detaje për planifikimin e kycjeve të reja gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë, kodin e objektit lokacionin dhe sipërfaqet ngrahëse.

Objektet e paraqitura në këtë tabelë, janë planifikuar të kycen gjatë sezonës ngrahëse 2025/2026, bazuar në realizimin e Projektit për zgjerimin /densifikimin e sistemit të ngrahjes qëndrore në lagjen "Lakrishtë " i cili do të financohet me mjete vetanake të NP"Termokos"Sh.A.

Planifikimi i kycjeve të reja për sezonin 2025/2026 është paraqitur në tabelën 6.

Objektet të cilat planifikohet të kycen në sezonin 2025/2026			
Planifikimi i kycjeve të reja në lagjen Lakrishtë			
	Nr. i nënstacioneve	Kapaciteti (kW)	Sipërfaqja (m2)
Totali Lakrishtë(L)	18	13,854	402,202.00

Objektet të cilat planifikohet të kycen në lagjen Lakrishtë			
Nr.	Objekti	Kapaciteti kW	Sip. m2
1	L1	Str. Lidhja e Pejes No.17 , No.18	2016
2	L2	Stores - Bill Klinton	1764
3	L3	Bill Klinton No.38, No.40	473
4	L4	Bill Klinton No.30, No.32	473
5	L5	Bekim Fehmiu - Puka design U.C.	55440
6	L6	Beni Dona - Donika II kompleks U.C	34804
7	L7	Robert Doll - Raiffaisen bank	7154
8	L8.1	Shoping center	7778
9	L8.2	West Tower	27283
10	L8.3	East Tower	41216
11	L8.4	Shoping center	14571
12	L9	Robert Doll - Nartel center	31570
13	L10	Bekim Fehmiu - Fazita 4	32340
14	L11	Bekim Fehmiu - Fazita 5 U.C	23800

15	L12	Str. Ukshin Hoti – Prime Residence II U.C	1,334	49140
16	L13	Str. Ukshin Hoti – Prime Residence III U.C	688	21315
17	L14	Str. Ukshin Hoti – Marigona Tower U.C	690	20930
18	L15	OAK Tower – hotel U.C	1,319	30135
Total:			13,854	402,202.00

Tabela 6. Planifikimi i kycjeve të reja gjatë sezonit 2025/2026

6. Planifikimi i Investimeve me vetfinansim dhe bashkëfinansim të projekteve gjatë periudhës (15 tetor 2025- 15 tetor 2026)

6.1. Projekti për “Ndërtimin e Objektit të ri Administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse “

Meqenëse objekti ku aktualisht është i vendosur stafi administrativ i NP “Termokos”SH.A, është objekt shumë i vjetër, dhe nuk i plotëson kushtet elementare për punë, është paraqitur nevoja e realizimit të një projekti për ndërtimin e një objekti të ri në hapsirat e NP “Termokos”SH.A.

Ky projekt përfshinë Ndërtimin i objektit të ri administrativ me sipërfaqe 3,913.20 m², me etazhitet S+P+3 dhe Renovimin e hapësirave përcjellëse të NP “Termokos”SH.A .

Nënshkrimi i kontratës me kontraktorin për ndërtimin e objektit dhe renovimin e hapësirave përcjellëse, është bërë me datë 28.07 2023.

Vlera e kontratës është : 2,433,753.60 euro.

Deri tani, shuma e paguar për realizimin e projektit është: 1,365,713.82 euro

Lidhur me këtë projekt janë nënshkruar edhe dy kontrata:

1. Kontrata nr.NP Termokos.sh.a-24-10040-5-2-5/C212 – “Punë shtesë për ndërtimin e objektit të ri administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse “ me vlerë 238,104.00euro .

2. Kontrata nr.Np Termokos.sh.a-25-378-5-2-1/C245 -- "Punët e papapapame për ndërtimin e objektit të ri administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse " me vlerë 399,983.00 euro.

Ky projekt në tërësi është duke u financuar nga Np" Termokos" sh.a me mjete vetanake .

Punimet për realizimin e projektit kanë filluar me 08.08.2023 dhe në bazë të kontratës është dashur që të përmbyllet në muajin shkurt 2025, mirëpo për shkak të disa punëve të papapapara dhe disa pengesave tjera të paparashikuara, planifikohet që punimet të finalizohen së shpejti.

Zhvillimi i punimeve:

- Ndërtimi i vrazhde është përfunduar, i cili përbëhet nga sutereni, përdhesa dhe tri kate, që të gjitha janë të përfunduara. Të gjitha ndarjet në objekt, si ato me blloka dhe me knauf janë të përfunduara.
- Kulmi është i përfunduar me gjitha shtresat e parapara.
- Është e përfunduar fasada strukturale-xhamat, një pjesë e objektit, ndërsa për pjesen tjetër të objektit janë duke u zhvilluar punimet për fasaden me tulla.
- Në katin e tretë, dytë dhe parë është përfunduar edhe nivelizimi dhe suvatimi i këtyre tri kateve, ndërsa në përdhesë dhe suterren është përfunduar vetëm suvatimi.
- Është duke u punuar edhe në qeramikë të banjove, veshja e shkallëve me mermer, si dhe fillimi i shtrimit të parketit në katin e 3-të.
- Në oborr është duke u punuar në rrugën ekonomike e cila lidhet me depon e objektit.
- Gjithashtu edhe rrethoja-gardhi i oborrit thuhet të jetë përfunduar.

Gjatë periudhës raportuese (15 tetor 2025/ 15 tetor 2026) planifikohet që të paguhet shuma prej **1,706,126.73 euro** për realizimin e projektit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detaje për investimet-projektet, që planifikohet të realizohen me mjete vetanake të N.P"Termokos"SH.A, gjatë periudhës tetor 2025/tetor 2026.

6.2. Projekti "Pristina Heat Save" për mirëmbajtjen dhe instalimin e pajisjeve matëse dhe rregulluese

Në janar të vitit 2025 është vazhduar faza e dytë e projektit "Pristina Heat Save" për mirëmbajtjen dhe instalimin e pajisjeve matëse dhe rregulluese në objektet në të cilat nuk janë përfunduar plotësisht instalimet në fazën e parë. Faza e dytë e këtij projekti do të financohet me fondet e Termokosit si bashkëfinancues i projektit me 1 milion € dhe në këtë fazë planifikohet të përfshihen edhe 2,500 konsumatorë të ri.

Termokos është duke shqyrtuar mundësinë e gjetjes së donatorëve për mbështetje financiare për zgjerimin e këtij projekti në të gjitha lagjet ku shtrihet rrjeti i ngrohjes qendrore, në mënyrë që të krijohet mundësia që të gjithë konsumatorët të faturohen në bazë të konsumit.

Qëllimi i realizimit të këtij projekti është njehësimi (matja) e konsumit të ngrohjes qendrore, që konsumatorët e NP "Termokos" Sh.a në Prishtinë të kalojnë nga faturimi në bazë të sipërfaqes ngrohëse në faturim në bazë të konsumit të matur, gjë që do të mundësojë:

- Kontrollimin e konsumit të energjisë termike nga konsumatori,
- Kursimi i energjisë termike,
- Zgjerimi i rrjetit të Termokos (nga kapacitetet e kursyera), për të rritur numrin e konsumatorëve të cilët janë duke shfrytëzuar energjinë elektrike për ngrohje,
- Termokos të ofrojë shërbime inovative për konsumatorët e saj,
- Mbrojtja e mjedisit.

Në fazën e dytë të projektit planifikohet të instalohen:

- Valvula termostatike: 12 347 copë;
- Alokatorë: 6 348 copë;
- Matës të energjisë termike: 744 copë;
- Pompa qarkulluese: 105 copë;
- Valvula balancuese - 171 copë.

Në tabelën 7 është paraqitur Raporti i Punimeve të realizuara me projektin "Prishtina Heat Save" nga fillimi i punimeve në fazën e parë të projektit deri në prill 2025.

Raporti i Punimeve të realizuara me projektin "Prishtina Heat Save" deri në prill 2025				
Lagja	Nësi banesore	Valvola dhe Termokoka	Aldatore të përdoruesit	Matës të energjisë termike
Bregu i Diellit	2641	12700	11818	37
Dardania	3177	14016	14074	0
Kalabria	1636	6955	3634	701
Mati 1	6407	22803	11396	2946
Qendër	2925	12375	9198	786
Ulpianë	2255	8783	7559	0
Total	19041	77632	57679	4470

Tabela 7. Raporti i Punimeve të realizuara me projektin "Prishtina Heat Save" deri në prill 2025

Gjatë periudhës raportuese (15 tetor 2025/ 15 tetor 2026), për këtë projekt nga shuma e planifikuar prej 1,000,000.00 €, për furnizim dhe instalim të pajisjeve matëse dhe rregulluese janë ndarë 750,000 euro, nga të cilat gjatë 2025 janë paguar 112,178 euro, ndërsa për shërbime të konsulencës janë planifikuar 250,000 euro, nga të cilat deri tani janë paguar 100,000.00 euro .

Për sqarime të detajizuara për këtë projekt, bashkangjitur ua dërgojmë dokumentin "Adendum no.2 DOC. NO. 250326-01 26/03/2025", e cila përmbanë:

- 1.Përmbledhjen e survejimeve, të ndara sipas hyrjeve dhe pajisjeve të identifikuara,
- 2.Përmbledhjen e instalimeve të papërfunduara, ku janë instaluar vetëm valvolat termostatike,
- 3.Përmbledhjen e artikujve të nevojshëm .

6.3.Projekti për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes në lagjen “Lakrishtë” (objektet e reja shumikateshe)

Krahas projekteve të cilat janë realizuar, gjatë kësaj periudhe raportuese, NP“Termokos”SH.a parasheh mundësinë e zgjerimit të rrjetit të ngrohjes në lagjen Lakrishtë (objektet e reja shumikateshe), bazuar në kapacitetet aktuale të cilat mundësojnë një zgjerim të tillë.

Mbulimin e kostos për realizimin e këtij projekti për zgjerimin e rrjetit (për instalimin e termopërquesit dhe ndërtimin e 18 nënstacioneve me rreth 402,000.00 m² sipërfaqe ngrohëse) do të bëhet me mjete vetanake nga Termokos.

Për mbulimin e kostos së këtij projekti, Termokos ka ndarë buxhetin në vlerë prej 2,300,000.00 milion euro. Parashihet që projekti të realizohet brenda dy vitesh.

Për realizimin e projektit është zhvilluar procesi i tenderimit në dy Lote (Lot 1 për rrjetin e tubacionit dhe Lot 2 për termonënstacionet).

Për Lot- 1 “Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes” është nënshkruar kontrata me datë 29.07.2025 :

Lot-1 Kontrata Nr. NP Termokos sh.a -25-601-5-1-1 - “Zgjerimi i rrjetit dhe intervenimi në nënstacionin termik” me vlerë 788,933.91 euro. Planifikohet që gjatë periudhës raportuese për Lot 1 të realizohet vlera prej 600,000.00 euro.

Ndërsa për Lot -2 “Nënstacionet termike”, tenderi është publikuar me datë 6 shkurt 2025, mirëpo meqenëse të gjitha ofertat kanë qenë të papërgjegjshme, tenderi është anuluar dhe së shpejti pritet ritenderimi.

Planifikohet që gjatë periudhës raportuese për Lot 2 “Nënstacionet termike”, të realizohet vlera prej 800,000.00 euro. Ndërsa në total për këtë projekt gjatë periudhës raportuese planifikohet të realizohet investimi prej 1,400,000.00 euro .

➤ 6.4.Bashkëfinancimi për Projektin me KFW/Programi i Energjisë VIII dhe IX – Projekti “Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qëndrore në qytetin e Prishtinës” (2021 - 2024)

1. Kontrata T-1, MZ ID 201667575 / Procurement No. 505734 Supply and Installation of Heat Storage, Thermal Substations, Chemical Water Treatment and SCADA

Vlera Totale e kontratës T-1 është: 8.600,000.00 €

Punët për furnizimin e instalimin e pajisjeve për nënstacionet dhe rezervuarët e nxehtësisë, sipas kontratës kanë përfunduar, por tek pjesa e rezervuarëve të nxehtësisë, ende nuk është bërë testi i performancës i cili planifikohet të bëhet në sezonin e ardhshëm 2025/2026.

Gjithashtu edhe për nënstacionet, kemi disa kërkesa për përmirësim të sistemit SCADA.

Për këtë shkak ka mbetur pa paguar edhe faktura e fundit -- punët e kryera plus 5%, në vlerë rreth 300,000.00 euro.


Për periudhën raportuese (tetor 2025- tetor 2026) për kontratën T-1, planifikohet të realizohet vlera prej 300,000.00 euro nga fondet e Termokosit.

Ky investim është paraqitur si investim vetanë në Tabelën 8. Planifikimi i Investimeve me vetfinancim dhe bashkëfinancim

Investimet me mjete vetanake të Termokosit (15 tetor 2025 - 15 tetor 2026)				
Distribubimi				
Përshkrimi	Periudha (tetor - dhjetor 2025)/ €	Periudha (janar - tetor 2026)/€	Total (tetor 2025 –tetor 2026)/€	
Gypa të paraizoluar	70,000	80,000	150,000	
Këmbyes	20,000	20,000	40,000	
Pompa qarkulluese		40,000	40,000	
Valvola dhe Filtra	49,000	50,000	99,000	
Kalorimatës	15,000	20,000	35,000	
Furnizim me automjete (eskavator)		120,000	120,000	
Vetëfinancim për Projektin për zgjerim të rrjetit në lagjen” Lakrishtë- objektet shumëkatëshe”	1,400,000.00		1,400,000	
Lot 1 – Instalimi i rrjetit gypor				
Lot2 - Instalimi i termonënstacioneve				
Total Distribubimi : 1,884,000 euro				
Prodhimi				
Prodhimi -planifikimi 2025-2026				
Përshkrimi	tetor - dhjetor 2025 /€	janar -tetor 2026/€	Total (tetor 2025 –tetor 2026)/€	
Furnizim me fletëza dhe diktuna për këmbes të nxehtësisë 50MW me shërbim (montim)		120,000	120,000	

Pjesë rezervë për pompa	50,000	50,000
Pjesë rezervë për sistem të koogjenierimit	30,000	30,000
Servisimi i vinçit urë në NQ dhe në stacionin "Bregu i Diellit"	10,000	10,000
Kalibrimi i matësve të energjisë në stacionin HES-HRS	10,000	10,000
Shpenzimet për bazhdarimin e valvolave siguruese	5,000	5,000
Funksionalizimi i sistemit për detektim të rrjedhjeve në rrjet të koogjenierimit	95,000	95,000
Mirëmbajtja e rjetës së koogjenierimit (riparime të rrjetit, izolimit, etj)	50,000	50,000
PC industriale dhe backup i serverit për HRS, për rezervë	10,000	10,000
Pjesë rezervë për elektrike/automatike	15,000	15,000
Furnizimi me HMI, programi dhe mundësimi i monitorimit në kohë reale të shpenzimit me energji elektrike	14,000	14,000
Ndërprerësa, bashkë me panela dhe zbara të instaluara për tensionin 0.4kV (Switch gear), nga sekondarët e 2 transformatorëve 1600kVA	95,000	95,000
Licencimi i softuerëve të kontrollit PLC dhe SCADA	10,000	10,000
Suport i jashtëm për probleme komplekse dhe editime në softuerin PLC-së dhe SCADA	40,000	40,000
Servisim i zbutësave	15,000	15,000
Instalimi i zbutësave të ri për rrjet të distributimit	60,000	60,000
Total Prodhimi : 629,000 euro		

Administrata			
Administrata planifikimi 2025-2026			
Përshkrimi	Periudha (tetor - dhjetor 2025) / €	Periudha (janar - tetor 2026) / €	Total (tetor 2025 - tetor 2026) / €
Ndërtimit të objektit Administrativ	1,706,127		1,706,127
Furnizimi me Kompiuter, Laptop dhe printera, ploter .	20,000	20,000	40,000
Blerja e licenceve të Sistemit Operativ dhe Microsoft Office		60,000	60,000



Termokos

Ngrahorja e Qytetit
për të gjithë përdoruesit e PC.

Total:						
Total Administrata: 1,806,127 euro						
Total i Investimeve vetanake (distributim, proçhim dhe administratë) - 4,319,127 euro						
Investimi - Bashkëfinancim për Projektet zhvillimore						
Përshkrimi	Periudha (tetor - dhjetor 2025)/ €	Periudha (janar -tetor 2026)/€	Total /€			
Bashkëfinancimi për Projektin me KFW/Programi i Energjisë VIII dhe IX - per realizimin e projektit	Pako tenderuese T1	300,000	300,000			
Bashkëfinancimi për Projektin e MCC – Instalimi i matësve të energjisë termike	Për projektin	637,822	787,822			
	Për shërbime të konsulencës	150,000				
Total bashkëfinancim: 1,087,822 euro						
Grand Total - Investimet nga mjetet vetanake: 5,406,949 euro						

Tabela 8. Planifikimi i Investimeve me vetfinancim dhe bashkëfinancim

7. Planifikimi i Investimeve nga Donacionet gjatë periudhës (15 tetor 2025- 15 tetor 2026)

Në kuadër të investimeve të planifikuara nga donacionet gjatë periudhës raportuese (15 tetor 2025- 15 tetor 2026) është përfshirë vetëm Projekti i prodhimit të energjisë termike përmes energjisë diellore “Solar 4 Kosova II”.

Sqarim: Në këtë periudhë raportuese nuk është përfshirë “Projekti për dyfishimin e kapaciteteve të ekstraktimit të energjisë termike nga sistemi i kogjenerimit nga 140MW_{TH} në 280MW_{TH}”, për arsye se marrëveshja e financimit është ende e padefinuar për shkak të masave nga BE për Republikën e Kosovës.


7.1. Projekti i prodhimit të energjisë termike përmes energjisë diellore “Solar 4 Kosova II”

Projekti për prodhimin e energjisë termike përmes energjisë diellore “Solar 4 Kosova II”, është projekti më i madhi në Ballkan dhe i dyti në Evropë pas Danimarkës, në fushën e energjisë diellore.

Projekti përfshinë ndërtimin e implantit termik diellor dhe integrimin në sistemin ekzistues të ngrohjes qendrore duke përfshirë zgjerimin e rrjetit me kapacitetin deri në 50MW_{TH}. Ky projekt parashihet të ketë koston në vlerë prej rreth 87 milion euro. Projekti “Solar 4 Kosova II” do të financohet nga Qeveria Gjermane nëpërmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) në vlerë të 53.1 milion eurove, prej të cilave 21.5 milion euro grant dhe 31.6 milion euro kredi, BERZH me 18.9 milion euro kredi dhe rreth 15.1 milion euro nga kontributi vetanak i NP “Termokos”Sh.A si bashkëfinansues i këtij projekti.

Aktivitetet e realizuara deri tani sa i përket zhvillimeve për këtë projekt, janë:

- Studimi i fizibilitetit,
- Projekti VNMS (Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social), i punuar nga CES-IC dhe financuar nga KfW,
- Është definuar dhe aprovuar lokacioni në zonën Hade e Re prej 25 ha tokë, për vendosjen e paneleve solare dhe rezervuarit të energjisë ngrohëse,
- Është nënshkruar kontrata me kompaninë konsulente për projektin, kompania IC –CES Consulanten nga Vienna, në muajin janar 2024,
- Kemi marrë pëlqimin elektronergjetik në KEDS (kygja e implantit në trafon 110/10(20)kV) dhe për kushte të kyqjes në rrjetin e ujësjellësit të KRU Prishtina.



Ngrahitja e qytetit

➤ Është aprovuar PPR (Planning Project Report),

➤ Është aprovuar në parim Masterplani i ri për zgjerimin e rrjetit në kuadër të këtij projekti,

➤ Janë aprovuar nga KfW "Termat e Referencës" për shpalljen e Tenderit për parakualifikim të kompanive të interesuara për pjesëmarrje në projekt/parakualifikimi është në proces,

➤ Termokos ka angazhuar kompani konsulente të licencuar lidhur me elaboratin e shpronësimit/servitutit për korridoret e gypave dhe dorëzimi në MFPT,

➤ Është përgatitur Dizajni i optimizuar për implantin solar termik , llogaritja e CO2, plani i sigurisë së diges (depozites së ujit), matjet gjeomekanike, mostrat laboratorike të dheut etj.,

➤ Është shpallur tenderi për Loti 1 – Implanti i Ngrohjes Qendrore "Solar4Kosovo SDH II " , në janar 2025.

➤ Është marrë pëlqimi elektronergjetik në KEDS (kyqja e implantit në trafon 110/10(20)kV) dhe për kushte të kyqjes në rrjetin e ujësjellësit të KUR.

➤ Është angazhuar konsulencia FOPIP/ESAP, kontrata pritet të nënshkruhet gjatë muajit maj 2025.

➤ Kemi aplikuar në institucionet përkatëse për pëlqimet /lejet e nevojshme.

➤ Në proces është Elaborati i shpronësimit për pjesën e trasesë për korridorin A dhe B.

➤ Ka përfunduar procesi i vlerësimit të aplikacioneve për parakualifikim për tenderin "Solar 4 Kosova II" dhe raporti i vlerësimit për parakualifikim është dërguar në bankën e KfW për miratim. Pas miratimit të këtij raporti, fillon procesi i tenderimit për ekzekutim të punimeve.

➤ Nëse çdo gjë shkon sipas planifikimeve, punimet për realizimin e projektit do të fillojnë në tremujorin e parë të vitit 2026 . Sipas planit dinamik, projekti duhet të zgjasë 51 muaj plus 12 muaj shtesë për komisionim.

Për projektet e financimit me donacion, për projektin e përfuturit të energjisë termike nga energjia diellore "Solar 4 Kosova II", në bazë të raportit të fundit zyrtar të datës 16.07.2025 " Quarterly Progress Report, No. 05 iC - CES 16.07.2025", është paraqitur skema e planifikimit të shpenzimeve nëpër vite për këtë projekt. Bazuar në të dhënat e këtij dokumenti, për vitin 2025 për projektin planifikohet të paguhet shuma në vlerë prej 530,663 euro, ndërsa për vitin 2026 planifikohet të paguhet shuma prej 21,019,042euro, nga shuma totale e të cilave 2,787,300 euro të janë të dedikuara për shërbimet e konsulencës.

Bazuar në raportin e lartcekur, për periudhën raportuese (15 tetor 2025- 15 tetor 2026) për projektin "Solar4 Kosova II", nga donacionet planifikohet të realizohet vlera prej 21,549,705 euro, nga të cilat 18,762,405.00 euro të dedikuara për zhvillimin e projektit dhe 2,787,300.00 euro për shërbimet e konsulencës.

Bashkangjitur ua dërgojmë tabelën e shpenzimeve të planifikuara nëpër vite, në kuadër të Raportit "Quarterly Progress Report, No 05 IC - CES 15.07.2025", për projektin "Solar 4 Kosova II".

Ky investim i planifikuar është paraqitur si investim nga donatorët në Tabelën 9.

Planifikimi i Investimeve nga donacionet për periudhën (15 tetor 2025- 15 tetor 2026)					
Donatori	Projekti		Total (tetor 2025-dhjetor 2025) /€	(janar 2025- tetor 2026) /€	Total /€
1 EBRD, KfW, Komisioni Europian	"Solar 4 Kosova II "		530,663	18,231,742	18,762,405
				2,206,441	2,787,300
Total për projektin "Solar 4 Kosova II " : 21,549,705.00€					
Total investimet nga donacionet : 21,549,705.00€					

Tabela 9. Përmbledhje e Investimeve të planifikuara nga donacionet